

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Papunësia e të rinjve dhe njoftimet për vende pune, reale apo thjesht marketing?
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392661.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 08:52:54 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	19 shtator 2026, 08:47:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 19 shtator 2026, 08:46:00 UTC → 19 shtator 2026, 08:48:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e1eba2558f84bb374a2e835b8f71dd0cecc8dc7a88c85a33b448d9d8cc8af8ee
TEKSTI	0e93e641d75945c3bf5b20dd4c84862bbd21051b6cfb824b60dfa48dad5e005c
PAMJA	f2dd3f27cc4d50eabf9eaf6282e237aeb7421dad6b459c86a8d481a7659a3664

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c60c275af6ffe9da02e2b73a441fd1d071207789ed260662c8a5440ff423b750
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d9bc965f5b1d123533150ed32fd4f601072aed3f2d6cedb2b9fe07ef4eb329bf
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c60c275af6ffe9da02e2b73a441fd1d071207789ed260662c8a5440ff423b750>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Papunësia e të rinjve dhe njoftimet për vende pune, reale apo thjesht marketing?

Shkruar nga: A Shehaj | Publikuar më: 19.09.2026, 10:47



Papunësia e të rinjve dhe njoftimet për vende pune, reale apo thjesht marketing?

Një shqetësim i ngritur nga studentët dhe të rinj që janë në kërkim të një vendi pune lidhet me njoftimet për vende vakante që publikohen në rrjetet sociale por s'ofrojnë asnjë lloj pune në të vërtetë.

Në disa raste këto njoftime për punësim shfaqen në rrjete sociale ose vendosen jashtë bizneseve dhe vazhdojnë të qëndrojnë aty për ditë të tëra. Por kur personat e interesuar telefonojnë, dërgojnë mesazh apo shkojnë personalisht për të pyetur, marrin përgjigjen se vendi i punës është tashmë i zënë ose mbeten edhe pa përgjigje fare për ditë e javë të tëra.

Kjo situatë ka krijuar pikëpyetje te personat që janë realisht në kërkim të punës.

"A janë të gjitha njoftimet që shohim vende pune reale dhe aktualisht të disponueshme, apo mbahen aktive si reklama boshe edhe pasi pozicioni është plotësuar?"

Për studentët që kërkojnë të punojnë paralelisht me studimet dhe të sigurojnë të ardhura, një njoftim i papërditësuar nuk është thjesht një detaj. Telefonatat, mesazhet dhe 'intervistat' në biznese u marrin kohë dhe krijojnë pritshmëri për një mundësi që mund të mos ekzistojë kurrë.

"Vetëm të na thonë që vendi është zënë, që ta dimë edhe ne çfarë të bëjmë. Nuk është problem nëse një vend pune është plotësuar, por njoftimi duhet të hiqet ose të bëhet e ditur që pozicioni nuk është më vakant", shprehet një prej të rinjve që ka hasur këtë situatë.

Shqetësimi ngre një diskutim më të gjerë mbi mënyrën se si publikohen dhe përditësohen njoftimet për punësim. Në një kohë kur shumë të rinj kërkojnë punë dhe konkurrojnë për një numër të kufizuar mundësish, transparenca mbi vendet realisht vakante bëhet edhe më e rëndësishme.

Të paktën një gjë do të ishte e mjaftueshme për ata që kërkojnë punë: në momentin që pozicioni plotësohet, njoftimi të hiqet ose të bëhet e ditur qartë se vendi nuk është më vakant. Kështu, ata që janë në kërkim të një pune mund të mos humbasin kohë dhe të vazhdojnë të kërkojnë mundësi të tjera reale.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.